




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

Janar – Mars, 2019

-III- Nr. i prot. 455 Më 26.04 2019
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim në 3 mujorin e parë të vitit 2019 ka punuar në përputhje të plotë me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtij 3 mujori. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura sipas muajve, siç vijon:

1. Në fillim të muajit Janar është mbajtur takimi i parë i këtij viti kalendarik me drejtorët e shkollave. Pas këtij takimi, është themeluar dhe funksionalizuar Ekipit Profesional Monitorues dhe Vlerësues në kuadër të DKA-së dhe Aktivat Profesionale. Ky ekip do të përbëhet prej 11 anëtarëve, në të cilin janë përfshirë të gjitha aktivitat profesionale. Poashtu, gjatë muajit Janar, DKA ka nisur hartimin e projekteve të parapara të fillojnë në vitin 2019, siç janë projektet për ndërtimin e shkollave, projektet për ngrohjen qendrore në shkollat e komunës sonë, projektet në drenazhimin dhe hidroizolimimin e disa shkollave, etj. Më 16 Janar, drejtori i DKA-së realizoi një takim me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit për t'i koordinuar aktivitetet që do të mbahen në të ardhmen për shkollimin profesional dhe orientimin e të rinjve në karrierë. Me këtë rast, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërmjet DKA-së dhe Agjencisë për Zhvillim të Luksemburgut, që nëpërmjet projektit KSV/015 të krijohet Sistemi i Informimit për Orientim në Karrierë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. DKA organizoi dhe mbajti 3 punëtori me 3 aktive profesionale, në të cilat u diskutua për hartimin e planeve të veprimit. Më 23 Janar, drejtori i DKA-së mori pjesë në një punëtori të organizuar nga Qendra e Kosovës për Arsim në Prishtinë, lidhur me programin e kësaj qendre dhe organizatës USAID për aplikimin e shkollave profesionale në programin ASSET, që ka të bëjë me orientimin profesional të të rinjve në shkollat profesionale dhe në gjimnaze. Me këtë rast, Shkolla e Mesme e Lartë "XHELAL HAJDAR-TONI" e komunës sonë përmes DKA-së ka aplikuar në këtë program. Aktivat profesionale të fushave kurrikulare, nën organizimin e DKA-së kanë mbajtur takimet e tyre konsultative, lidhur me harmonizimin e instrumenteve të vlerësimit. Takime të tilla mbajtën Fushat Kurrikulare të Matematikës, Niveli fillor dhe parafillor, Fusha e Arteve, Fusha Jeta dhe Puna dhe Fusha Shoqëria dhe Mjedisi.
2. Në muajin Shkurt, Aktivat Profesionale të fushave kurrikulare, nën organizimin e DKA-së kanë mbajtur takimet e tyre konsultative, lidhur me harmonizimin e instrumenteve të vlerësimit. Më 11 Shkurt, drejtori i DKA-së mbajti takim në MASHT me Ministrin e Arsimit, ku u diskutua për çështjen e kompensimit të orëve të humbura gjatë grevës, për zbatimin e udhëzimit administrativ për moslejimin e përdorimit të telefonave gjatë procesit mësimor dhe për

organizimin e matures shtetërore. Më 4 Shkurt, drejtori i DKA-së ka zhvilluar një takim në MASHT me Këshillin Britanik, për prezantimin e projektit "Shkollat e shekullit 21". Më 8 Shkurt, drejtori i DKA-së ka zhvilluar një takim me Kolegjiun për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës për Planin e Punës 2019 të këtij kolegjiun. Në datat 12, 13, 14 dhe 15 Shkurt, u mbajtën 4 debate me të gjithë mësimdhënësit e 4 fushave kurrikulare, në të cilat u finalizua harmonizimi i instrumenteve të vlerësimit të njohurive të nxënësve. Debatet u realizuara gjatë kësaj jave ishin ato me mësimdhënësit e këtyre fushave kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, Sporti dhe Shëndeti, Shoqëria dhe Mjedisi dhe Matematika. Në datat 20, 21, dhe 22 Shkurt, u mbajtën 3 debate me të gjithë mësimdhënësit e 3 fushave kurrikulare, në të cilat u finalizua harmonizimi i instrumenteve të vlerësimit të njohurive të nxënësve. Debatet u realizuara gjatë kësaj jave ishin ato me mësimdhënësit e këtyre fushave kurrikulare: Shkencat e Natyrës, Jeta dhe Puna dhe fusha e Arteve. U mbajtën garat shkollore të olimpiadës matematike në secilën shkollë, ndërsa më 23 shkurt u organizua dhe u mbajt gara komunale e olimpiadës së matematikës, ku pjesëmarrës ishin nxënësit fitues të garave shkollore nga klasat e 9, 10, 11 dhe 12.

3. Në muajin Mars, janë mbajtur aktivitete dhe manifestime të ndryshme të organizuara nga DKA për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit. Janë përgatitur paramasat për projektet e ngrohjes qendrore në 3 shkolla dhe paramasat për drenazhimin dhe hidroizolimimin e 2 shkollave. Për dy ditë me radhë është mbajtur punëtoria me anëtarët e Ekipit Profesional për Monitorim dhe Vlerësim për harmonizimin final të instrumenteve të vlerësimit. Nga kjo punëtoria, është përgatitur një document unik për të gjithë mësimdhënësit e komunës sonë, i cili ofron instrumente unike vlerësimi, të cilat do të vihen në përdorim gjatë punës së tyre të përditshme me nxënës. Drejtori i DKA-së ka marrë pjesë në lansimin e projektit "Shkollat e Shekullit 21", organizuar nga MASHT dhe Këshilli Britanik. Pjesë e realizimit të këtij projekti tashmë janë edhe shkollat e komunës sonë. Është hapur tenderi për projektin e ndërtimit të Shfmu " Liria" në Fortesë, tenderi për ngrohje qendrore në 3 shkolla dhe tenderi për drenazhimin dhe hidroizolimimin e 2 shkollave. Drejtoria, së bashku me kryetarin e komunës ka mbajtur një takim me drejtorët e shkollave, në të cilin u diskutua për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për përgatitjet për garat shkollore dhe komunale. Ekipi i psikologëve dhe pedagogëve filloi me vizitat njoftuese në disa shkolla të komunës. Drejtori i DKA-së ka vizituar Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc dhe paralelen e ndarë fizike në Senoc, Shfmu "4Dëshmorët" në Ratkoc, Shfmu "Sapniqi" në Sapniq dhe SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe.

